



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

KËSHILLI DREJTUES

Nr. 85 Prot.

Datë 30.07.2020

VENDIM

Nr. 06, datë 30.07.2020

PËR

SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 5, DATË 20.1.2011 "PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT FINANCIAR TË PUNONJËSVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL DHE KËSHILLIT DREJTUES", TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 18, DATË 29.6.2012

Bazuar në nenin 6, gërma "e" e Ligjit Nr. 10233, datë 11.2.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", të ndryshuar, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, Këshilli Drejtues,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e Vendimit Nr. 5, datë 20.1.2011 "Për miratimin e trajtimit financiar të punonjësve të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe Këshillit Drejtues", të ndryshuar me Vendimin Nr. 18, datë 29.6.2012.
2. Shërbimi i telefonisë celulare për punonjësit e Autoritetit të Aviacionit Civil të ofrohet sipas specifikimeve të Vendimit nr. 864, datë 23.07.2010 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik".
3. Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në 1 Gusht 2020.

KRYETAR

Dritan Gjonbalaj

Dritan
Gjonbala

Digitally signed by
Dritan Gjonbalaj
Date: 2020.07.30
02:17:34 +02'00'